



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.04.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë në pozicionin e lirë në fushën e së drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:32 dhe mbaroi në orën 10:39.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

10. Brikena Ukperaj (anëtare)

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Luan Dibra, Rezarta Taushani dhe Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

3. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)

4. Denisa Varfi, Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë në pozicionin e lirë në fushën e së drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e radhës, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datës 28 prill.

Siç jeni në dijeni sot janë tre çështje për të cilat kërkohet vendimmarrja juaj.

Çështja e parë në fakt që është një nga çështjet më të rëndësishme është propozimi për emërim në Gjykatën e Lartë në pozicionin e lirë në fushën e së drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe që do relatohet nga zoti Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Faleminderit Kryetare!

Atëherë, kemi përgatitur relacionin mbi projektvendimin paraprak “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë në pozicionin e lirë në fushën e së drejtës

administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji, në ushtrim të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor dhe në veçanti të funksionit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve, në kuadër të plotësimit të pozicioneve të lira në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, ndër të tjera, ka hapur procedurat e ngritjes në detyrë edhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative, respektivisht me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021.

Në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, brenda afatit të kandidimit, kandiduan gjithsej gjashtë kandidatë dhe konkretisht: znj. {...}; z. {...}; z. {...}; z. {...}; znj. {...} dhe znj. {...}. Konkretisht, kandidimet për këtë pozicion të lirë paraqitet në formë tabelare si më poshtë: [...] dhe janë paraqitur në formë tabelare emrat e cituar më lart.

Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit, të emërimit në Gjykatën e Lartë në rastin konkret, Këshilli realizoi procedurat e verifikimit të plotësimit nga secili kandidat të kriterëve të më poshtme:

1) “përvojës profesionale minimale”, sipas pikës 5, të nenit 47, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “5. Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë Gjykatës së Lartë dhe Prokurorisë së Përgjithshme, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”;

2) “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, sipas pikës 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, përcaktohet se: “8. Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”;

3) “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, sipas nenit 8, të Ligjit për Statusin, përcaktohet se: “1. Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë. 2. Këshillat,

gjatë ... ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë jopropocionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, efënca e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë. 3. Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni; ... 5. Për efekt të zbatimit të kësaj dispozite, magjistrati, në momentin e paraqitjes së kërkesës për ... ngritje në detyrë, paraqet një vetëdeklarim përpara Këshillit, ku deklaron nëse ndodhet apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni. ...”;

4) “të pasurisë dhe figurës”, sipas pikave 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “7. Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji”, si dhe: “8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës ..., pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.

Me synimin për plotësimin në kohë të pozicioneve të lira, ndër të tjera, edhe në Gjykatën e Lartë, kjo me qëllim për bërjen e kësaj të fundit funksionale në një kohë sa më të shpejtë, Këshilli, në të gjitha procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat më të larta ose të specializuara, ka konsideruar zhvillimin paralelisht të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, me atë të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve për secilin nga pozicionet e lira. Kështu, për të filluar në kohë procesin e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, çka do të mundësonte më pas përmbylljen e procedurës së përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, Këshilli konsideroi ndarjen në dy faza të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit. Në fazën e parë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t’i nënshtroheshin verifikimit për tre kriteret formale të kandidimit, pikërisht atyre të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, në logjikën sipas të cilës kandidati që nuk i plotësonte këto kriteret do të duhej të skualifikohej nga kandidimi, duke mos u bërë kështu ai pjesë e procedurës së vlerësimit

etik dhe profesional, pra për të lehtësuar këtë proces dhe synuar përfundimin në kohë të tij. Ndërsa në fazën e dytë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t'i nënshtroheshin verifikimit të kriterit të pasurisë dhe të figurës. Vetëm pas verifikimit të të gjithë kriterëve të kandidimit, Këshilli do të vendoste përfundimisht për kualifikimin ose jo të çdo kandidati.

Ndërsa procedura e verifikimit të plotësisht të kriterëve ligjore të kandidimit ishte në vijim, kandidatja znj. {...} u tërhoq nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Mbi këtë kërkesë, me vendimin nr. 105, datë 25.03.2022, Këshilli vendosi: “Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion”.

Lidhur me kandidimin e z. {...}, me vendimin nr. 50, datë 08.02.2022, Këshilli vendosi skualifikimin dhe përjashtimin e tij nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, në kushtet kur për të u verifikua mosplotësimi i kriterit të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, ndërsa ndaj kandidatit ishte dhënë masa disiplinore “shkarkim nga detyra”, me vendimin nr. 298, datë 17.09.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ndaj këtij vendimi, kandidati paraqiti ankim pranë Gjykatës Administrative të Apelit, ndërkohë që kjo e fundit me vendimin nr. 37, datë 01.06.2022 vendosi rrëzimin e padisë.

Dua të theksoj që para dy ditëve vendimi i shkarkimit të tij, pra nga KPK, është konfirmuar edhe nga KPA.

Për katër kandidatët e tjerë, Këshilli i Lartë Gjyqësor verifikoi plotësimin nga ata të të gjitha kriterëve të kandidimit, duke vendosur kualifikimin e tyre dhe vijimin e procedurave përkatëse për ngritjen në detyrë/emërimin në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira respektive ku ata kanë kandiduar. Konkretisht:

1) Për z. {...}, i cili ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021 si dhe për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 536 dhe nr. 537, datë

17.11.2021, Këshilli, me vendimin nr. 174, datë 05.05.2022, ka vendosur kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë;

2) Për znj. {...}, e cila ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021 si dhe për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 536 dhe nr. 537, datë 17.11.2021, Këshilli, me vendimin nr. 130, datë 06.04.2022, ka vendosur kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë;

3) Për znj. {...}, e cila ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021 si dhe për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 536 dhe nr. 537, datë 17.11.2021, Këshilli, me vendimin nr. 129, datë 06.04.2022, ka vendosur kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë;

4) Për z. {...}, i cili ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021, Këshilli, me vendimin nr. 115, datë 29.03.2022, ka vendosur kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë;

Siç u parashtrua, krahas procedurave të verifikimit të kriterëve të kandidimit, paralelisht, për kandidatët kanë vijuar edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, konkretisht: 1) vlerësimi me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016 (periudhën e rivlerësimit kalimtar), referuar pikës 5, të nenit 171, të Ligjit për Statusin; 2) vlerësimi i përsheptuar për vitin 2021, referuar pikës 3, të nenit 25, “Dispozitë kalimtare”, shtuar në këtë ligj me Ligjin nr.48/2019.

Ndërsa proceset e verifikimit të kriterëve të kandidimit dhe atyre të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve vijonin, për përfundimin në kohë të procedurave tërësore të ngritjes në detyrë, propozimit për emërim në Gjykatën e Lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 193, datë 27.05.2022, filloi procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Me këtë vendim, si relator i procedurave të përzgjedhjes u caktua anëtari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z. Hallunaj.

Më datë 27.05.2022, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 30, të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, kandidatët e kualifikuar u njoftuan për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, si dhe për caktimin e relatorit. Kandidatët nuk paraqitën kundërshtime apo kërkesa për përjashtimin e relatorit apo për ndonjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit.

Gjatë vijimit të procedurës së përzgjedhjes, njëri nga kandidatët, z. {...}, paraqiti kërkesë për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e përzgjedhjes, kërkesë e cila u miratua më vendimin nr. 258, datë 15.07.2022 të Këshillit. Me anë të këtij vendimi, Këshilli vendosi përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021 për kandidatin z. {...}.

Në zbatim të shkronjës “a”, pika 47, të vendimit të Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” (më poshtë referuar si Vendimi 70/2020), relatori ka administruar dokumentacionin përkatës për secilin kandidat të kualifikuar, që gjendej në dosjet e tyre personale apo në praktikat dokumentare të procedurave të verifikimit të plotësimit të kriterëve të kandidimit. Po ashtu, relatori ka administruar edhe vendimet përkatëse të Këshillit në lidhje me dy vlerësimet etike dhe profesionale për kandidatët e kualifikuar. Duhet përmendur se njëra nga kandidatët, znj. {...}, ka ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit vendimin e Këshillit për vlerësimin etik dhe profesional për vitin 2021, konkretisht vendimin e këshillit nr. 537, datë 14.12.2022. Lidhur me këtë vendim, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 19, datë 27.03.2023 ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë. Si e tillë, ky vendim konsiderohet se ka marrë formë të prerë.

Në situatën si më lart, siç mund të konstatohet, procedura e përzgjedhjes, pra renditja e kandidatëve dhe përzgjedhja e kandidatit të renditur më lart me qëllim propozimin e tij për emërim në Gjykatën e Lartë, mund të vijojë dhe të përmbillet sa i përket procedurës së ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 535, datë 17.11.2021, në rrethanat kur për kandidatët e këtij pozicioni të lirë ka përfunduar procedura e verifikimit dhe për ata ka dy vlerësime etike dhe profesionale.

Ndaj mbi sa u parashtrua në pikën 13, të këtij relacioni, relatori administroi tërësisht dokumentacionin e nevojshëm në funksion të përmbylljes së procedurës së përzgjedhjes sa i përket procedurës së ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 535, datë 17.11.2021.

Kështu, për kandidatin z. {...} u administruan edhe dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 456, datë 02.11.2022 dhe nr.3, datë 16.01.2023, vendime të cilët janë përfundimtarë, ndërsa ndaj tyre nuk është paraqitur ankim referuar informacionit të dërguar përmes komunikimit elektronik nga Gjykata Administrative e Apelit, protokolluar pranë KLGJ-së me nr. {...} prot., datë 25.04.2023.

Për kandidaten znj. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 536, datë 14.12.2022 dhe nr. 537, datë 14.12.2022, vendime të cilët tashmë janë përfundimtarë. Kjo e fundit ka ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit vendimin e Këshillit për vlerësimin etik dhe profesional për vitin 2021, konkretisht vendimin e Këshillit nr. 537, datë 14.12.2022. Lidhur me këtë vendim, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 19, datë 27.03.2023 ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë. Si e tillë, ky vendim konsiderohet se ka marrë formë të prerë. Ndaj vendimit nr. 536, datë 14.12.2022 nuk rezulton të jetë paraqitur ankim brenda afatit ligjor, referuar informacionit të dërguar përmes komunikimit elektronik nga Gjykata Administrative e Apelit, protokolluar pranë KLGJ-së me nr. 2519 prot., datë 25.04.2023.

Për kandidaten znj. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 4, datë 16.01.2023 dhe nr. 161, datë 06.04.2023, vendime të cilët janë përfundimtarë, ndërsa ndaj tyre nuk është paraqitur ankim referuar deklaratës së kandidatit, përmes komunikimit elektronik të datës 18.04.2023, përmes të cilës ka shprehur dakordësinë për të. Ndërsa, lidhur me vendimin nr. 4, datë 16.01.2023, referuar informacionit të dërguar përmes komunikimit elektronik nga Gjykata Administrative e Apelit, protokolluar pranë KLGJ-së me nr. {...} prot., datë 25.04.2023, nuk rezulton të jetë paraqitur ankim.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në përputhje me Kreun IV të vendimit 70/2020, relatori realizoi renditjen e kandidatëve për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur nga Këshilli me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021, për ngritjen në detyrë/emërimin në Gjykatën e Lartë.

Lidhur me renditjen e kandidatëve u mbajt në konsideratë pika 9, e Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “9. Këshillat shqyrtojnë kandidimet dhe rendisin kandidatët që përmbushin kriteret, sipas rezultateve të mëposhtme: a) së pari, dy vlerësimet e mëparshme, duke pasur parasysh: i) që përvoja në pozicionet e komanduara, si magjistrat në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit që i ka mbaruar mandati tre vite përpara kandidimit do të ketë përparësi; ii) në rastet e më shumë kandidatëve me rezultate të njëjta, magjistratët brenda grupit të kandidatëve me rezultatet më të larta të vlerësimit do të renditen sipas skemës së pikëve, të përcaktuar nga këshillat; b) së dyti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës "a", të pikës 9, të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë, sipas përvojës profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë; c) së treti, në rast se pas vlerësimit të bërë, sipas shkronjës "b", të pikës 9, të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë sipas vjetërsisë si magjistrat ose jurist”.

Po ashtu, për renditjen e kandidatëve u mbajtën në konsideratë hapat, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve, sipas përcaktimeve të vendimit 70/2020, dalë në zbatim të pikës 14, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “14. Këshillat miratojnë rregulla më të detajuara, të cilat përcaktojnë: a) kriteret për vlerësimin ndërmjet kandidatëve me nivel të njëjtë vlerësimi etik dhe profesional; b) kriteret për vlerësimin e përvojës profesionale që kërkohet për pozicionin e lirë; c) procedurën që ndiqet në rastin e kandidatëve me rezultate të njëjta; ...”.

Në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 535, datë 17.11.2021, u përfshinë tre kandidatë, konkretisht: z. {...}, znj. {...}, znj. {...}. Për këta kandidatë u verifikua plotësimi i dy kërkesave të ligjit për të qenë pjesë e procedurës së përzgjedhjes për këtë pozicion të lirë, në kushtet kur ata ishin kualifikuar në procedurën e ngritjes në detyrë/emërimin ndërsa plotësonin kriteret e kandidimit, si dhe kishin dy vlerësime etike

dhe profesionale, sikurse kërkohet për efekt renditje nga shkronja “a”, pika 9, e nenit 48, të Ligjit për Statusin, i ndryshuar dhe përcaktohet në shkronjën “c”, pika 7 dhe në pikën 46, të vendimit 70/2020.

Për renditjen e kandidatëve, fillimisht u ndoq hapi i parë i renditjes, ku për secilin kandidat u bë një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 48, pika 9, shkronja “a”, të Ligjit për Statusin, si dhe të detajuara në Seksionin B, Kreu IV, të vendimit 70/2020.

Siç u parashtrua, në pikën 9, të Ligjit për Statusin, përcaktohet se: “9. Këshillat shqyrtojnë kandidimet dhe rendisin kandidatët që përmbushin kriteret, sipas rezultateve të mëposhtme: a) së pari, dy vlerësimet e mëparshme, ...”. Ndërsa në pikën 12, të vendimit 70/2020, përcaktohet se: “Renditja e kandidatëve bazohet në vlerësimin krahasues të niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Kandidati me nivelet më të larta të vlerësimit etik dhe profesional, renditet më lart”.

Referuar kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, për kandidatët u konstatua sa më poshtë:

a) Për z. {...} - Sipas vendimit të Këshillit nr. 456, datë 02.11.2022, kandidati është vlerësuar/graduar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”; Sipas vendimit të Këshillit nr. 3, datë 16.01.2023, kandidati është vlerësuar për vitin 2021, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”;

b) Për znj. {...} - Sipas vendimit të Këshillit nr. 536, datë 14.12.2022, kandidati është vlerësuar/graduar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”; Sipas vendimit të Këshillit nr. 537, datë 14.12.2022, kandidati është vlerësuar për vitin 2021, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”;

c) Për kandidaten znj. {...} - Sipas vendimit të Këshillit nr. 4, datë 16.01.2023, kandidati është vlerësuar/graduar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”; Sipas vendimit të Këshillit nr.161, datë 06.04.2023, kandidati është vlerësuar për vitin 2021, në nivelin “Shkëlqyeshëm”.

Nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, rezultoi se vetëm njëri nga kandidatet ka të dyja vlerësimet në nivelin “Shkëlqyeshëm”, ndërsa rezultoi se dy kandidatët e tjerë,

respektivisht znj. {...} dhe z. {...} kanë një vlerësim “Shkëlqyeshëm” dhe një vlerësim “Shumë mirë” (konkretisht vlerësimin për vitin 2021).

Referuar pikës 12, të vendimit 70/2020, përcaktohet se: “12. Renditja e kandidatëve bazohet në vlerësimin krahasues të niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Kandidati me nivelet më të larta të vlerësimit etik dhe profesional, renditet më lart.”

Referuar përparësisë së parë për kriterin e parë të renditjes, pra asaj sipas “nivelet të vlerësimit të fundit”, nisur nga sa më lart u parashtrua, për kandidatët u konstatua që kanë nivel të ndryshëm vlerësimi, konkretisht znj. {...} ka nivel vlerësimi, “Shkëlqyeshëm”, për të dy vlerësimet etiko – profesionale, ndërsa dy kandidatët e tjerë kanë nivel “Shkëlqyeshëm”, për njërin vlerësim dhe nivel “Shumë mirë”, për vlerësimin tjetër. Për pasojë, renditja e kandidatëve mund të bëhet sipas kësaj përparësie. Mbi këtë bazë arrihet të bëhet renditja e kandidatëve, për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 535, datë 17.11.2021, ku më lart renditet kandidatja znj. {...}, ndërsa kandidatët e tjerë renditen pas saj, duke mos pasur rëndësi për këtë procedurë përzgjedhjeje renditja mes tyre e kandidatëve të tjerë, pra e kandidatëve me nivele vlerësimi të njëjta më të ulëta, znj. {...} dhe z. {...}.

Për pasojë, renditja e kandidatëve për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 535, datë 17.11.2021, rezulton si më poshtë:

- 1) Znj. {...};
- 2) Znj. {...} dhe z. {...};

Në nenin 48, të Ligjit për Statusin, përcaktohet se: “... 11. Për procedurën e ngritjes në detyrë, për plotësimin e një pozicioni të lirë në Gjykatën e Lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor propozon me shkrim emërimin e kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore, duke arsyetuar përmbushjen e kriterëve dhe duke bërë renditjen e kandidatëve, sipas procedurës dhe rregullave të parashikuara në pikat 9 dhe 14 të këtij neni. 12. Propozimi për emërimin është i ankimueshëm. Rregullat e parashikuara në nenin 41, pikat 2 deri në 4, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim. ... 13. Ngritja në detyrë e gjyqtarit me

renditjen më të lartë dekretohet nga Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 136, pika 2, të Kushtetutës”.

Në shkronjën “m”, pika 7, të vendimit 70/2020, përcaktohet se: “Vendim paraparak i propozimit për emërim”, nënkupton vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor për renditjen e kandidatëve për në Gjykatën e Lartë dhe propozimin për emërim të kandidatit të renditur më lart”. Kurse në pikën 8, të këtij vendimi, përcaktohet se: “Renditja e kandidatëve bëhet me qëllim përzgjedhjen e kandidatit më të mirë për pozicionin e lirë”.

Kandidati i renditur më lart sipas pikës 23, të këtij relacioni, pra znj. {...}, siç u parashtrua, ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë edhe për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 536, datë 17.11.2021 dhe nr. 537, datë 17.11.2021. Ndërkohë, konstatohet se janë paraqitur preferencat lidhur me këto kandidime, ku sa i përket pozicionit të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021 ajo e paraqet si preferencë të parë. Për pasojë, për këtë kandidate është e zbatueshme preferenca e kandidimit.

Në nenin 48, të Ligjit për Statusin, përcaktohet se: “... 11. Për procedurën e ngritjes në detyrë, për plotësimin e një pozicioni të lirë në Gjykatën e Lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor propozon me shkrim emërimin e kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore, duke arsyetuar përmbushjen e kriterëve si dhe duke bërë renditjen e kandidatëve, sipas procedurës dhe rregullave të parashikuara në pikat 9 dhe 14 të këtij neni. 12. Propozimi për emërimin është i ankimueshëm. Rregullat e parashikuara në nenin 41, pikat 2 deri në 4, aplikohen për atë që gjejnë zbatim. ... 13. Ngritja në detyrë e gjyqtarit me renditjen më të lartë dekretohet nga Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 136, pika 2, të Kushtetutës”.

Bazuar në sa përcaktohet në më sipër këtij relacioni, bazuar në rezultatin e renditjes sipas pikës 23 të tij, relatori përgatiti projektvendimin paraparak “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Sipas pikës 1 të projektvendimit paraparak, Këshilli i propozohet të miratojë renditjen e gjyqtarëve që kandidojnë për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë

17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: 1) znj. {...}; 2) znj. {...} dhe z. {...}.

Bazuar në sa përcaktohet në pikat 24 dhe 25, të këtij relacioni, sikundër edhe në rezultatin e renditjes sipas pikës 23 të tij, por edhe të rrethanës sipas pikës 26, relatori përgatiti projektvendimin paraprak “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Sipas pikës 1 propozohet renditja që përcaktuam më lart.

Sipas pikës 2 propozohet të vendosë propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të kandidatës znj. {...}, pra të kandidatës së renditur e para në këtë pozicion.

Në pikën 3 të projektvendimit paraprak, përcaktohet se një kopje e arsyetuar e vendimit iu njoftohet kandidatëve znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Në pikën 4 të projektvendimit paraprak, përcaktohet se kundër vendimit mund të bëhet ankim nga çdo kandidat, në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Së fundi, në projektvendimin paraprak përcaktohet se ky vendim botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky projekt-akt është shqyrtuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në mbledhjen e datës 25.04.2023, siç përcaktohet në Seksionin C, Kreu VI, të vendimit 70/2020, ku pasi ka konstatuar si të plotë dokumentacionin e administruar për kandidatët në këtë procedurë, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Hallunaj.

Atëherë, nëse nuk kemi ndonjë diskutim nga kolegët, kalojmë në miratimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e renditjes së gjyqtarëve që kandidojnë për t'u emëruar në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.535, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

- 1) znj. {...};
- 2) znj. {...} dhe z. {...};

2. Propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të kandidatës Znj. {...}.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit iu njoftohet kandidatëve znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

4. Kundër vendimit mund të bëhet ankim nga çdo kandidat, në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi (*menjëherë*) dhe botohet në faqen e internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.04.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:

2.1 Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;

2.2 Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;

2.3 Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarit {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;

2.4 për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:32 dhe mbaroi në orën 10:39.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)

- | | |
|----------------------------|------------------|
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 10. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 11. Yllka Rupa | (anëtare) |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.**
- 2. Luan Dibra, Rezarta Taushani dhe Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 3. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)**
- 4. Denisa Varfi, Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:
 - 2.1 Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;
 - 2.2 Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;
 - 2.3 Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarit {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme;
 - 2.4 për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek akti tjetër që ka të bëjë me fillimin e procedurës së transferimit. Në fakt janë disa akte të cilat vijnë të propozuara nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe bëhet fjalë për transferimin e tre (*në fakt janë katër*) gjyqtarëve: të znj. {...}, znj. {...} dhe të zotit {...} (*është edhe zonja {...} që gabimisht nuk citohet*).

Për më shumë detaje fjalën ia jap zotit Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Relacioni në fjalë ka lidhje me gjendjen e faktit dhe zbatimin e mekanizmave ligjorë për gjyqtarët që rezultojnë mbi organikë, pas implementimit të hartës së re gjyqësore në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Berat, Gjirokastrë, Shkodër.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, sipas vendimit të Këshillit nr.146, datë 29.03.2023 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm” është përcaktuar se organika do të jetë 8 (tetë) gjyqtarë.

Nga 10 (dhjetë) gjyqtarë që ishte më parë organika e kësaj gjykate, organika e saj pas datës 1 maj 2023 do të jetë e konfiguruar si më poshtë: struktura organizative (9), organika në fakt (11), efektivisht në detyrë (6).

Aktualisht në këtë gjykatë ushtrojnë funksionin {...} (zv.kryetarja aktuale), {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}.

Sa më sipër, rezulton se në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat do të rezultojnë 3 (tre) gjyqtarë mbi organikë më datën 1 maj 2023.

Sa i përket gjyqtarës {...}, ajo është aktualisht gjyqtare e skemës së delegimit dhe gjykon për llogari të Gjykatës së Krimeve të Rënda, dhe efektet financiare përballohen nga kjo e fundit - për rrjedhojë nuk sjell pasoja në strukturën organizative të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

Sa i përket gjyqtarës {...}, është e transferuar përkohësisht me pëlqim në Gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë (për një periudhë deri 1 vit), sipas vendimit të Këshillit nr. 94, datë 06.03.2023 dhe efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e

Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për rrjedhojë edhe kjo gjyqtare nuk sjell pasoja në strukturën organizative të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

Sa i përket gjyqtarës {...}, kjo e fundit është e transferuar me pëlqim sipas vendimit të Këshillit nr. 217, datë 16.06.2022 deri në 21.06.2023 në Gjykatën e rrethit gjyqësor Kavajë, e cila më datë 30.04.2023 suprimohet. Në pikën 3 të nenit 2, të vendimit të Këshillit nr. 130, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës” parashikohet se: “Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, të cilit i suprimohet pozicioni për shkak të riorganizimit gjyqësor, transferohet në pozicion të përhershëm në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.” Në kushtet kur kjo gjyqtare ka pozicion të përkohshëm dhe jo të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, arrihet në përfundimin se kthehet në pozicionin e mëparshëm, atë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për të cilën siç u shpjegua më sipër rezulton që të jetë mbi organikë. Në kushtet kur me vendimin nr. 217, datë 16.06.2022, të Këshillit, znj. {...} është e transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë deri më 21.06.2023, Komisioni vlerëson se marrja e masave për përfundimin e transferimit të saj para afatit është emergjente në rrethanat kur në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat situata është mbi organikë.

Në këto rrethana lind nevoja për transferimin pa pëlqim të kësaj gjyqtare, konform germës “b” të pikës 1 të nenit 44 në ligjin për statusin. Kjo normë parashikon se: “1.Magjistratët transferohen pa pëlqim vetëm në këto raste: ...b) kur pozicioni i magjistratit suprimohet për shkak të ndryshimeve në strukturën administrative ose në kompetencën tokësore të gjykatave ose prokurorive, pas kryerjes së një vlerësimi, bazuar në kritere objektive dhe transparente.”

Paraprakisht, znj. {...} dhe znj. {...} kanë paraqitur kërkesë për transferim në një pozicion të lirë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Mes gjyqtarëve të cilët duhet të transferohen prej Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, znj. {...} është ajo të cilës duhet t’i aplikohet transferimi pa pëlqim pasi: i) prej gati 5 vjetësh nuk ka kontribuar në Gjykatën e rrethit

gjqësor Berat (për shkak të transferimit të përsëritur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë) dhe si e tillë duke mos pasur çështje të ngarkuara në atë gjykatë nuk do të sillte aspak pasoja në rishpërndarjen e ngarkesës ndërmjet gjyqtarëve të tjerë që ushtrojnë funksionin në atë gjykatë; gjithashtu element i rëndësishëm është ii) për shkak të vjetërsisë së saj të konsiderueshme në sistem prej 11 vjetësh.

Më tej po kalojmë në situatën në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, sipas vendimit të Këshillit nr. 146, datë 29.03.2023, është përcaktuar se organika do të jetë 7 (shtatë) gjyqtarë.

Nga 10 (dhjetë) gjyqtarë që do të ishte organika, nëse do të kishte bashkim matematik mes Gjykatës Gjirokastër dhe asaj Përmet, organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër pas datës 1 maj 2023 do të jetë e konfiguruar si më poshtë: Struktura organizative (7), organika në fakt (9), efektivisht në detyrë (4).

Aktualisht kjo gjykatë do të përbëhej nga zëvendëskryetare {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}.

Në vendimin nr. 132, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër” në nenin parashikohet se: “2. Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër qëndron në pozicion në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër. 3. Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet, të cilit i suprimohet pozicioni për shkak të riorganizimit gjyqësor, transferohet në pozicion të përhershëm në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

Sa më sipër lind nevoja për të aplikuar transferim pa pëlqim për gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, konform germës “b” të pikës 1 të nenit 44 në ligjin për Statusin. Kjo normë parashikon se: “1. Magjistratët transferohen pa pëlqim vetëm në këto raste: ...b) kur pozicioni i magjistratit suprimohet për shkak të ndryshimeve në

strukturën administrative ose në kompetencën tokësore të gjykatave ose prokurorive, pas kryerjes së një vlerësimi, bazuar në kritere objektive dhe transparente.”

Në kushtet kur znj. {...} është e komanduar në ILD - deri në përfundim të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, lind nevoja për transferim vetëm për 1 (një) nga 3(tre) gjyqtarët të cilët ushtrojnë detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Duke mbajtur në vëmendje faktin se: i) znj. {...} është aktualisht me leje lindje dhe nuk ka ngarkesë të çështjeve në atë gjykatë, duke mos sjellë pasoja në rishortimin e tyre; ii) ka vjetërsinë më të madhe ndërmjet gjyqtarëve të cilët ushtrojnë funksionin në atë gjykatë, Komisioni vlerëson se gjyqtari për të cilin duhet të aplikohet mekanizmi i transferimit pa pëlqim është znj. {...}.

Kalojmë tek situata në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Në këtë gjykatë, sipas vendimit të Këshillit nr. 146, datë 29.03.2023, është përcaktuar se organika do të jetë 15 (pesëmbëdhjetë) gjyqtarë.

Nga 18 (tetëmbëdhjetë) gjyqtarë që do të ishte organika, nëse do të kishte bashkim matematikor midis Shkodrës dhe Pukës, organika e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër pas datës 1 maj 2023 do të jetë e konfiguruar si më poshtë: Struktura organizative (15), organika në fakt (17), efektivisht në detyrë (10).

Aktualisht kjo gjykatë do të përbëhet nga z. Sokol Shehu (zv.kryetar), {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}.

Në vendimin nr. 136, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër” në nenin parashikohet se: “2. Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër qëndron në pozicion në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. 3. Gjyqtari i emëruar/caktuar në një pozicion të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, të cilit i suprimohet pozicioni për shkak të riorganizimit gjyqësor, transferohet në pozicion të përhershëm në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Sa më sipër lind nevoja për të aplikuar transferim pa pëlqim për gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, konform gurmës “b” të pikës 1 të nenit 44 në ligjin për statusin.

Në konfigurimin më të fundit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, shtrohet çështja e transferimit pa pëlqim për 2 (dy) nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

Duke mbajtur në vëmendje faktin se: i) z. {...} ka vjetërsinë më të madhe ndërmjet gjyqtarëve të cilët ushtrojnë funksionin në atë gjykatë, Komisioni vlerëson se një prej gjyqtarëve për të cilin duhet të aplikohet mekanizmi i transferimit pa pëlqim është z. {...}.

Duke mbajtur në vëmendje faktin se: i) znj) {...} është aktualisht e shkarkuar nga KPK-ja, në pritje të vendimit të KPA-së dhe nuk ka ngarkesë të çështjeve në atë gjykatë, duke mos sjellë pasoja në rishortimin e tyre; ii) është gjyqtare me vjetërsi më të madhe, Komisioni vlerëson se gjyqtarja tjetër për të cilën duhet të aplikohet mekanizmi i transferimit pa pëlqim është znj. {...}.

Vlerësimi i Komisionit në lidhje me gjykatat ku ka një pozicion të lirë të përhershëm:

Komisioni vlerëson se, duke mbajtur në vëmendje situatën aktuale në gjykatat e shkallës së parë, siç është parashtruar në mbledhjen plenare të datës 18.01.2023, si edhe situatën e krijuar pas vendimit të Këshillit nr.146, datë 29.03.2023, gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm të cilat kanë pozicione të lira dhe u propozohen magjistratëve mbi organikë janë:

Gjykata shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë për të cilën ngarkesa është paraqitur në formë tabelare dhe në fund rezulton me një ngarkesë jo vetëm vrastare por edhe ulëritëse - 20 835 çështje ngarkesë.

Pastaj vijon Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Edhe për të është paraqitur në formë tabelare tabela përkatëse dhe në përfundim të saj rezulton të jetë me një ngarkesë - 3 235 çështje.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, gjykatë e cila

në organikë ka vetëm 5 gjyqtarë efektivisht, për të cilën ngarkesa është në përfundim - 4 389 çështje.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë për të cilën ngarkesa e paraqitur po në formë tabelare, në përfundim vijon me 899 çështje.

Vijojmë pastaj me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë dhe Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

Për sa më sipër, Komisioni çmon që gjykatat që kanë pozicione të lira të përhershme dhe u propozohen magjistratëve mbi organikë janë si më poshtë:

Për znj. {...} - Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në fushën e së drejtës civile; Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, në fushën e së drejtës civile;

Për znj. {...} - Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan; Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë;

Për z. {...} - Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë; Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë

Për znj. {...} - Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë; Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Në këto projekt-akte parashikohet se e drejta e zgjedhjes sipas pikës më sipër duhet të ushtrohet brenda 1 (një) dite nga e nesërmeja e njoftimit të këtij vendimi, mbajtur në konsideratë faktin se në datën 1 maj fillojnë funksionimin gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm sipas hartës së re gjyqësore.

Ky ishte me pak fjalë relacioni.

Ndërkohë, bashkëlidhur relacionit janë bashkëlidhur të gjithë aktet individuale të transferimit pa pëlqim të gjyqtarëve të cilët unë citova.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Toro!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim mbi propozimet e ardhura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës? Kemi ndonjë diskutim?

Brikena Ukperaj: Unë kam një diskutim lidhur me situatën e papajtueshmërisë ambientale që mund të na krijohet në rastin e znj. {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Në zbatim të nenit 8 të ligjit “Për statusin” që bën fjalë për papajtueshmërinë ambientale, veç përkufizimeve të papajtueshmërisë, parashikohet edhe detyrimi i Këshillit që të marrë parasysh shmangien e kësaj papajtueshmërie në rastet kur transferon/emëron apo ngrin në detyrë gjyqtarët. Në këto kushte, në vlerësimin tim, duke marrë parasysh edhe qëndrimin që kam mbajtur edhe në një rast tjetër, mendoj që zonjës {...} nuk duhet t’i ofrohet si pozicion i lirë pozicioni në fushën e së drejtës civile në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për shkak se aty krijohet një papajtueshmëri ambientale duke qenë se edhe motra e saj është gjyqtare në të njëjtën gjykatë, pavarësisht se është në një seksion tjetër nga fusha e së drejtës ku zonjës {...} i është propozuar pozicioni për t’u transferuar. Kjo sepse sipas pikës 3 të nenit 8 të ligjit “Për statusin”, bëhet fjalë për të njëjtën gjykatë dhe jo për sa i përket seksioneve të ndryshme të së njëjtës gjykatë, pra ndalohet transferimi për shkak të papajtueshmërisë ambientale që mund të krijohet në të njëjtën gjykatë, pavarësisht se gjyqtarët me lidhje të tilla familjare mund të jenë në të njëjtin seksion apo në seksione të ndryshme. Bëhet fjalë për gjykatën si entitet, dhe jo gjykatën si godinë apo gjykatën si seksion.

Unë do të propozoja që zonjës {...} t’i ofrohej një pozicion i lirë në fushën e së drejtës civile në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe një pozicion po në të njëjtën gjykatë, por në fushën e së drejtës penale, duke marrë parasysh që sistemimi i saj është për shkak të suprimimit dhe nuk mund ta ekspozoja atë ndaj transferimit në një gjykatë më të largët sesa çka qenë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat. E kam vetëm për sa i përket papajtueshmërisë ambientale.

Ndërkohë që, dakordësohem plotësisht me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Karrierës edhe lidhur me gjyqtarët që janë evidentuar si gjyqtarë mbi strukturë, por edhe me gjykatat që janë propozuar për t’u transferuar, duke ruajtur në mënyrë proporcionale edhe ngarkesën e tyre, nevojat dhe funksionalitetin e gjykatave.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Po, zoti Toro!

Alban Toro: Natyrisht që Komisioni i ka vlerësuar të gjitha kriteret ligjore kur bëhen transferime të tilla dhe një nga këta është edhe papajtueshmëria ambientale dhe në momentin kur bën një propozim të tillë, natyrisht vlerësohen edhe këto komponentë.

Gjithashtu mund të them që aktualisht bëhet fjalë për transferimin e saj në një seksion civil i cili virtualisht përfaqëson një gjykatë tjetër dhe nuk ka afërsi apo kontakt me seksionin penal ku ushtron funksionin e afërmja e gjyqtares së propozuar për të shkuar në seksionin civil. Gjithsesi, them që është në të njëjtën frekuencë edhe me interpretimin që i ka bërë Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr. 34, një paragraf të cilin unë po e citoj (bëhet fjalë për paragrafin 31): “31. Në lidhje me pretendimet se nenet 8 dhe 44, pika 1, shkronja “c” të ligjit e tejkalojnë rregullimin kushtetues të neneve 138 e 143, gjykata konstaton se normat objekt kundërshtimi rregullojnë çështjen e papajtueshmërisë ambientale, e cila nënkupton atë lloj papajtueshmërie në ushtrimin e funksionit të magjistratit, që krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose persona të tjerë në lidhje të ngushtë gjaku ose me ligj, sipas parashikimeve të K.P.Civile. Ligji ka parashikuar detyrimin e magjistratit për të njoftuar pa vonesë Këshillat përkatës, të cilët ose e caktojnë magjistratin në një seksion tjetër (pra në rastin konkret Gjykata Kushtetuese e ka bërë dallimin midis gjykatave) ose në rast pamundësie, transferojnë një nga magjistratët në papajtueshmëri në gjykatën ose prokurorinë më të afërt të mundshme të të njëjtit nivel, në rast se magjistrati përmbush të gjitha kriteret e parashikuara për këtë pozicion.”

Pra ajo që dua të spikasë është që, aktualisht ne kemi parashikuar që për të shmangur papajtueshmërinë, ta caktojmë në një seksion i cili nuk ka lidhje me seksionin penal ku ushtron funksionin e afërmja e znj. {...}.

Natyrisht janë edhe kushtet, ka dhe një parim të cilin e kemi respektuar, duke parë dhe kushtet në të cilat ushtron aktivitetin dhe ngarkesën që ushtron aktivitetin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me 20 835 çështje në dorë, dhe ku Këshilli shpeshherë ka ndërhyrë qoftë me skemat e transferimit me pëlqim apo me lëvizjet paralele për ta

zbutur situatën, por për të ardhur keq që kjo frekuencë e Këshillit nuk ka gjetur mirëkuptim nga Këshillat përkatës të cilët e kanë orientuar prurjen që ne kemi dërguar në seksione të cilat nuk kanë ngarkesë ulëritëse dhe kështu që për “extremis malis” natyrisht kemi zgjedhur “extrema remedia” në rastin konkret duke preferuar që të vijojmë përpjekjet tona për të zbutur ngarkesën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke propozuar kësaj kandidateje (po supozohet që kjo kandidate do të zgjedhë Tiranën dhe prandaj po bëj gjithë këtë diskutim për Tiranën), duke propozuar në seksionin civil në të cilin ne nuk shikojmë që virtualisht apo për shkak të lëndës të ketë ndonjë pikë kontakti me funksionin dhe vendin ku ushtron e afërmja e zonja {...}. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Një sqarim të vogël, meqenëse nga zoti Toro u referuar edhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese. Në fakt në vendimin e saj Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar nenin 44, pika 1, germa “c” të ligjit “Për statusin” duke e lidhur me papajtueshmërinë ambientale dhe duke arritur në sintezën kushtetuese që gjyqtari nuk mund të transferohet pa pëlqim në rastin e suprimimit të pozicionit – kështu ka qenë... për shkak të papajtueshmërisë ambientale. Pra papajtueshmëria ambientale, jo automatikisht mund të sjellë transferim pa pëlqim për gjyqtarin pa i dhënë të drejtën e zgjedhjes. Ndërsa, në referim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, ligjvënësi ndryshoi pikën 2 dhe pika 2 e ligjit “Për statusin” parashikon që Këshillat gjatë emërimit, transferimit apo ngritjes në detyrë, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë jo proporcionale të drejtën e zhvillimit të karrierës duhet të marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale. Por në këtë rast ne e kemi të mundur shmangien e papajtueshmërisë ambientale (e para), dhe e dyta, nuk jemi para zhvillimit të karrierës, që mund të ishim para një procedure ngritjeje në detyrë apo procedure lëvizjeje paralele, jemi përpara një transferimi të detyruar që bëjmë për shkak të ndryshimit të strukturës së gjykatës apo suprimimit të pozicionit. Shmangien e situatës së papajtueshmërisë ambientale e bëjmë duke i ofruar gjyqtarës dy pozicione në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

(jo detyrimisht në Tiranë). Jam dakord që Tirana ka një ngarkesë të jashtëzakonshme të çështjeve, por nga ana tjetër jemi përpara detyrimit për shmangien e papajtueshmërisë ambientale. Për këtë pjesë doja të ndalesha në diskutimin e Albanit.

Pastaj nëse jemi apo jo në kushtet e papajtueshmërisë ambientale, kjo mbetet interpretimi i nenit 8. Unë mendoj që jemi. Mund të kemi dhe një interpretim të ndryshëm, që nuk jemi.

Por për shkak të një qëndrimi që kam mbajtur në një rast tjetër, isha e detyruar që ta ngrija si diskutim.

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Ukperaj!

Po, zoti Kurushi!

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Meqenëse kemi përgatitur relacionin në lidhje edhe me gjyqtaren {...}, e kemi marrë parasysh edhe situatën e papajtueshmërisë ambientale dhe kemi bërë një analizë tonën duke marrë në konsideratë Gjykatën e Tiranës, ambientet, sepse i referohemi papajtueshmërisë ambientale si ushtrojnë funksionet gjyqtarët në Gjykatën e Tiranës, seksionet të cilat janë të ndara në Gjykatën e Tiranës, në raport me gjykatat e tjera të republikës.

Me të vërtetë që është një çështje që prodhon diskutim – nuk është asgjë e qartë në këtë pikë - por në vlerësimin tonë kemi menduar të ndajmë disa situata dhe rrethana të cilat e bëjnë të diferencuar rastin konkret, me një situatë tjetër ku dy gjyqtarë për shkak të lidhjeve familjare mundet ose jo të ushtrojnë funksionin në një gjykatë tjetër të shkallës së parë, të ndryshme nga Gjykata e Tiranës.

Çfarë ndodh në Gjykatën e Tiranës dhe si ushtron funksionin Gjykata e Tiranës? E thamë që kemi të bëjmë me dy seksione të cilat janë të ndara qartësisht nga njëra – tjetra. Jo vetëm kaq, por edhe ambientet ku ushtrojnë funksionet gjyqtarët në këto dy seksione janë krejtësisht të ndara. Pra familjarët në Gjykatën e Tiranës, nëse ato do të ushtrojnë funksionet në seksionin penal ose në seksionin civil, janë të ndarë dhe nuk kanë kontakte me njëri-tjetrin gjatë ushtrimit të punës së tyre. Kjo është e para, pra selia dhe

ambienti. Këtë e kemi marrë në konsideratë për të thënë që Gjykata e Tiranës seksionet i ka të ndara dhe i ka në seli të ndryshme nga njëra-tjetra.

E dyta, kemi marrë në konsideratë edhe pjesën e funksioneve që ushtrojnë gjyqtarët e seksionit civil dhe seksionit penal në Gjykatën e Tiranës. Ne mendojmë që gjyqtarët e seksionit civil nuk kanë gjatë ushtrimit të funksionit të tyre si gjyqtar në Gjykatën e Tiranës, nuk kanë lidhje, ndikim, mbivendosje, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, qoftë në mënyrë të tërthortë, me funksionet që ushtrojnë gjyqtarët e seksionit penal në Gjykatën e Tiranës. Për ta konkretizuar me një shembull më të thjeshtë, gjyqtarët e seksionit penal e marrin çështjen penale nga fillimi deri në fund, pra shqyrtojnë masat e sigurimit, kërkesat e prokurorit në fazën e hetimit paraprak dhe gjykojnë çështjen në themel. Në këtë aspekt, gjyqtarët e seksionit civil të Gjykatës së Tiranës nuk interferojnë, nuk ndikojnë, nuk u përputhet funksioni i tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me funksionet e gjyqtarit penalist në seksionin penal të Gjykatës së Tiranës.

Pra referuar mënyrës së funksionimit, referuar numrit relativisht të lartë të gjyqtarëve që ushtrojnë funksionin në Gjykatën e Tiranës në raport me gjyqtarët e gjykatave të rretheve gjyqësore, referuar selive sepse i referohemi selive duke iu referuar kriterit ligjor, ambienteve, prandaj duhet të kemi edhe papajtueshmëri ambientale, mendojmë që në këtë rast nuk shkelim parimin e parashikuar nga neni 8 i ligjit “Për statusin”, atë të papajtueshmërisë ambientale.

Nëse situata do t’i referohej një gjykate tjetër, përtej Gjykatës së Tiranës (e ndryshme pra nga Gjykata e Tiranës), atëherë do të dakordësohesha me përfundimet dhe propozimet e bëra nga kolegja, znj. Ukperaj, sepse aty të gjitha këto kritere nuk gjejnë përputhshmëri: selia, funksionet, ambientet e përbashkëta.

Kështu që në këtë pikë, përtej diskutimeve që ekzistojnë, sepse nuk janë të qarta, ne si Komision kemi bërë këtë propozim, pra këtë qasje, sepse mendojmë që nuk ekziston rasti i papajtueshmërisë ambientale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës, ku realisht këto gjykata funksionojnë realisht si gjykata të ndryshme dhe të painerferuara në veprimtarinë e tyre me njëra-tjetrën.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse nuk ka diskutime, propozoj që të fillojmë votimin e projekt-aktit të parë i cili ka të bëjë me fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarës {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme, duke iu propozuar dy pozicione: një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në fushën e së drejtës civile dhe një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, në fushën e së drejtës civile. Jeni dakord?

Brikena Ukperaj: Kryetare, duhet të hidhni njëherë propozimin tim, që kisha një propozim të ndryshëm nga relatori.

Naureda Llagami: Kalojmë propozimin e znj. Ukperaj, që sugjeron që zonjës {...} t'i ofrohet vetëm Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, në fushën e së drejtës civile ose edhe penale.

Ilir Rusi: Kundër.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ridvan Hado: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Kundër.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Kundër.

Naureda Llagami: Kundër.

(Nuk miratohet propozimi i zonjës Ukperaj.)

Naureda Llagami: Kalojmë në propozimin e relatorit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Në kushtet kur Këshilli vendosi që nuk jemi në kushtet e papajtueshmërisë ambientale në thelb, jam dakord me propozimin.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares znj. {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat ku është caktuar në mënyrë të përhershme.

2. T'i kërkojë gjyqtares znj. {...}, të ushtrojë të drejtën e zgjedhjes për t'u transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme në gjykatat e të njëjtit nivel e së njëjtës lëndë me pozicionin e mëparshëm, si më poshtë:

i. Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në fushën e së drejtës civile;

ii. Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, në fushën e së drejtës civile;

3. E drejta e zgjedhjes sipas pikës 2 duhet të ushtrohet brenda 1 (një) dite nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

4. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Kalojmë tek propozimi i dytë për zonjën {...} ku i propozohen dy pozicione: një në Gjykatën e Rrethit Elbasan dhe një në Gjykatën e Rrethit Lezhë. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet propozimi i Komisionit.

Naureda Llagami: Kalojmë tek propozimi tjetër për gjyqtarin {...}. Edhe atij i propozohet dy pozicione të lira të përhershme: në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe një në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë. A jemi dakord me propozimin?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Edhe ky projekt-akt miratohet sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja e fundit e rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesave për caktimin e gjyqtarëve për çështje të caktuara në gjykatat që janë në nevojë.

Ndjesë, kemi edhe një projekt-akt tjetër që ka të bëjë me fillimin e procedurës së transferimit për gjyqtaren {...}. Edhe asaj i janë propozuar dy pozicione: një pozicion i lirë i përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe një pozicion i lirë i përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë. Jemi dakord me propozimin e Komisionit?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet propozimi i përcjellë nga Komisioni.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.04.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:32 dhe mbaroi në orën 10:39.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Illir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

10. Brikena Ukperaj (anëtare)

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Luan Dibra, Rezarta Taushani dhe Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

3. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-NL)

4. Denisa Varfi, Ardita Kurti dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Çështja e fundit e rendit të ditës lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet zotit Toro për të relatuar dy relacionet e përgatitura për këtë qëllim.

Relacioni i parë i trajtuar është “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës”. Kjo gjykatë ka kërkuar të caktohet një gjyqtar për numrin e çështjes 273, që përfaqëson një korrigjim vendimi.

Nuk është e mundur që të aplikohet skema e delegimit të gjyqtarit për shkak të mungesës së gjyqtarëve në të, gjithashtu as ajo e transferimit të përkohshëm pranë kësaj gjykate, për shkak se efekti që krijohet në këtë rast është më shumë negativ sesa pozitiv, kështu që e vetmja mundësi mbetet zbatimi i mekanizmit të caktimit të gjyqtarit për

gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme.

Kështu, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar që në çështjen penale, nevoja për caktim gjyqtari rregullohet në pajtim me nenin 385/a të K.Pr.Penale sipas të cilit: “1. Secila nga palët, brenda tridhjetë ditëve nga shpallja e vendimit në rastet kur kanë qenë të pranishme ose nga marrja dijani kur vendimi është shpallur në mungesë të tyre, mund të kërkojë plotësimin e tij, në rast se gjykata nuk është shprehur mbi të gjitha kërkesat për disponimin e provave. 2. Gjykata e shqyrton kërkesën me të njëjtin trup gjykues, pasi thërret palët. [...]” Në këto rrethana për plotësimin e trupit gjykues, caktohet gjyqtarja Elsa Ulliri.

Hidhet në votim miratimi i kërkesës së parë:

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Vijohet me trajtimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”. Kjo gjykatë ka kërkuar caktimin e një gjyqtari për kërkesën me nr. 290 të kësaj gjykate, me objekt të çështjes “Kryerja e veprave penale parashikuar nga nenet 248 dhe 258 të Kodit Penal”.

Aktualisht skema e delegimit dhe e transferimit të përkohshëm janë të pazbatueshme për arsyet e sipërcituara në kërkesën e parë dhe kështu e vetmja mundësi

mbetet zbatimi i mekanizmit të caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme.

Kështu, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon që për 1 (një) çështje, për të cilën kërkohet 1 (një) gjyqtar, të caktohet 1 i tillë, i cili të përzgjidhet, me short, ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm që plotësojnë kriteret: të ketë të paktën dhjetë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Bashkëlidhur është edhe lista e gjyqtarëve të cilët plotësojnë kriteret.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale (kërkesa nr. 290), gjyqtari Fuat Vjerdha.

Me përfundimin e shortit, mbledhja deklarohet e mbyllur.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor